



**Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”  
Fakulteti i Shkencave Shoqërore**

## **LIBRI I ABSTRAKTEVE**

Konferenca shkencore ndërkombëtare

# **Pikëtakime kulturore në arealin ballkanik**

**11 dhjetor 2023**

## Organizatorë



**Universiteti i Shkodrës  
“Luigj Gurakuqi”  
Fakulteti i Shkencave Shoqërore  
Departamenti i Gjuhësisë  
Departamenti i Letërsisë**

*në bashkëpunim me*



**Fakultetin Filologjik të Universitetit të  
Beogradit**



**Fakultetin Filologjik të Universitetit të  
Tetovës**

## **Bordi shkencor**

Prof.dr. Artan Haxhi

Prof.dr. Naile Mala Imami

Prof.dr. Berton Sulejmani

Prof.dr. Mimoza Priku

Prof.as.dr. Arben Prendi

Prof.as.dr. Orjeta Baja

Prof.as.dr. Valbona Karakaçi

Prof.as.dr. Rrezarta Dracini

Dr. Rezearta Murati

Dr. Merita Hysa

Dr. Ermira Alija

Dr. Gezim Puka

## **Bordi organizativ**

Prof.dr. Mimoza Priku

Prof.as.dr. Valbona Karakaçi

Prof.as.dr. Rrezarta Dracini

Prof.dr. Naile Malaj

Prof.as.dr. Orjeta Baja

Dr. Rezearta Murati

Dr. Merita Hysa

Dr. Gezim Puka

Rovena Mesi

## **Përmbajtja**

**Naile MALA IMAMI** - *Kontaktet e para kulturore me theks të veçantë në bashkëpunimin midis dy luftërave botërore*

**Berton SULEJMANI** - *Gjuha shqipe në Maqedoninë e Veriut sot (shqipja standarde dhe statusi i pabarabartë i shqipes me maqedonishten)*

**Alfred ÇAPALIKU** - *Pika takimi mes ninullave shqiptare të Veriut dhe të atyre malazeze.*

**Mimoza PRIKU** - *Statusi i shqipes në Mal të Zi dhe roli i saj në edukim*

**Rrezarta DRAÇINI dhe Merita HYSA** - *Gjama dhe vajtimet si simbole universale dhe pjesë e antropologjisë kulturore*

**Erzen KOPERAJ dhe Orjeta BAJA** - *Kontaktet gjuhësore shqiptaro-malazeze (një vështrim historik e gjuhësor mbi disa glosa)*

**Gëzim PUKA** - *Përkujdesja akademike për fjalën letrare në dy gjuhë fqinje*

**Maša VUKANOVIĆ** - *Bohemian quarter Skadarlija in the City of Belgrade. Representations of constructed spirit of the city*

**Miloš MILENKOVIĆ** - *Inclusive intangible cultural heritage research and safeguarding in the Western Balkans: Issues, perils, opportunities*

**Arben PRENDI** - *Kulturat e rrezikuara në novelat e Martin Camajt*

**Valbona KARAKACI** - *Takimi me Tjetrin si Sfidë apo Mundësi?*

**Rovena VATA MIKELI** - *Kultura dhe integrimi në edukimin bashkëkohor, një tipar dallues në shkrimet publicistike të Gjergj Fishtës”*

**Rezearta MURATI** - *Misioni ndërkulturor i Shtëpisë Botuese “Dielli” (Beograd-Prishtinë)*

**Ledia DUSHI** - *Të vajtosh në Ballkan –elemente të përbashkëta të ritualit mortor në Ballkan*

**Isida HOXHA, Ismet KALLABA** - *Pasqyrimi i konfliktit ndëretnik në mediat serbe dhe shqiptare (Rast studimor: Incidenti në Banjska)*

# **KONTAKTET E PARA KULTURORE DHE BASHKËPUNIMI MIDIS SHQIPTARËVE DHE SERBËVE NË FUSHËN E KULTURËS**

**Naile MALA IMAMI**

Katedra e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Fakulteti i Filologjisë,  
Universiteti i Beogradit, Serbi

## **Abstrakti**

Nga shqiptarët kontaktin e parë kulturor me serbët e krijoi Jovan (Joan) Çetiri. Ai lindi në Graovë afër Elbasanit, në Shqipëri të Mesme, shkoi në Sllavoni (Osijek) në mes të shekullit XVIII, në kohën kur këtu u vendos një numër i madh familjeve ortodokse nga Shqipëria dhe Maqedonia (familjet arumune, shqiptare, greke dhe sllave). Ishte nga familja Katro, anëtarët e së cilës në shekullin XVIII dhe XIX njiheshin si mjeshtër në pikturimin e afreskeve dhe të ikonave. I pari ndër ta ishte Gjergj Prend Çetir Grabovari, i cili me vëllanë e tij të vogël, Janin, e mësoi shkathtësinë e artit të pikturimit të vëllezërit Zografë në Korçë, në Shqipërinë Jugore. Rugën e tyre e ndoqën edhe djemtë e tyre Naumi, Nikolla dhe Ndini. Te serbët kontaktin e parë kulturor me shqiptarët e bëri iluministi Dositej Obradoviçi. Kur

në vitin 1768 e vizitoi Epirin dhe Shqipërinë Jugore, ai u ndal disa muaj në Hormovë, afër Gjirokastrës, ku filloi ta mësonte gjuhën shqipe. Si te popujt e shumtë në Evropë, ashtu edhe te serbët ishte në zë Gjergj Kastriot Skënderbeu. Disa shkrimtarë serbë botuan poezi për të. Njëri ndër ta është Andra Gavrilović, cili i shkroi dy vjersha për Skënderbeun dhe i botoi në vitin 1899 në librin *Vjershat lirike*, SKZ.

*Fjalë kyçe:* kontaktet, bashkëpunimi, folklori, melosi shqiptar, vjershat.

# **GJUHA SHQIPE NË MAQEDONINË E VERIUT SOT**

**(shqipja standarde dhe statusi i pabarabartë i  
shqipes me maqedonishten)**

**Berton SULEJMANI**

Faculty of Philology, University of Tetova,

Republic of North Macedonia

## **Abstrakti**

Në këtë kumtesë shkencore do t'i trajtojmë arritjet dhe problemet e gjuhës standarde shqipe në institucionet shtetërore dhe private të Maqedonisë së Veriut që nga Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe e deri më sot (1972 – 2023). Pjesë e kumtesës do të jetë edhe statusi i pabarabartë i shqipes me maqedonishten. Me ndryshimet e fundit kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në gazetën zyrtare të 14 janarit 2019 u shpall edhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Sipas këtij ligji, madje, po të krahasohet me ligjet paraprake, përkatësisht, nga pavarësimi i shtetit 1991 (emërtimi i mëparshëm: Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) e deri me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës (17 qershor 2018) mes IRJM-së dhe Greqisë, përdorimi i



gjuhës shqipe ka një ngritje, por nuk është plotësisht e barabartë me maqedonishten. Me fjalë të tjera, gjuha shqipe është në përdorim zyrtar, por jo zyrtare. Gjuha shqipe vetëm në dy shtete të Ballkanit është gjuhë zyrtare, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës, ndërsa në Maqedoninë e Veriut gjuha shqipe është pjesërisht zyrtare. Me përpjekjet e fundit të shqiptarëve në Mal të Zi, gjuha shqipe tashmë është bërë gjuhë zyrtare në dy komuna - në komunën e Ulqinit dhe në atë të Tuzit.

*Fjalë kyçe:* shqipja standarde, planifikimi dhe politika gjuhësore, gjuhë zyrtare, gjuhë në përdorim zyrtar.

# PIKA TAKIMI MES NINULLAVE SHQIPTARE TË VERIUT DHE TË ATYRE MALAZEZE

**Alfred ÇAPALIKU**

Qendra e Studimeve Albanologjike.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

## **Abstrakt**

Kjo kumtesë, prej 8 (tetë) faqesh, përmes gërshetimit të studimit kulturor shprehur në botën e brendshme të nënave shqiptare e malazeze dhe me letërsinë e krahasuar shprehur në folklorin malazez e shqiptar të veriut, trajton gëzimin e nënave të Ballkanit për ardhjen në jetë të vogëlushëve, si dhe përkujdesjen e madhe të tyre që ata të rriten sa më shpejt, me shëndet të plotë, me bukuri fizike. me mençuri e me pastërti morale. Ninullat te shqiptarët dhe te malazezët janë shprehje e individualitetit të nënave të reja, e karakterit të familjeve dhe e identitetit të kombeve. Këngët e gjuhës së djepit pasqyrojnë traditën me domethëniet e reja gjatë përkundjes së fëmijëve, qenieve më të dashura.

*Qëllimi i punimit:* Vëzhgimi krahasues evidenton paralelet folklorike ndërkufitare në kufirin gjuhësor shqiptaro – malazez.

*Sfondi kërkimor:*

1. Eqrem Çabej: Për gjenezën e letërsisë shqipe”. Shqiptarët mes Perëndimit dhe Lindjes. Tiranë 1994, f. 32.
2. Albert Doja, Kozma Vasili: “Shënim 1”. Lirika popullore 4”. Tiranë 1990, f. 408.
3. Nuhi Vinca: Antologji e lirikës popullore shqiptare”. Strugë 2004, f. 33.
4. Ismail Jashanica: Traditat tona (I). Tiranë 1997, f. 6.
5. Jelena Shauliq. “Parathënie”. Poezia lirike popullore në Mal të Zi”. Titograd 1995, f. 9.
6. Vuk Stef Karaxhiq. Këngë popullore serbe. Libri i parë. Beograd 1976, f. 184.(Fus. 98).

*Metodologjia:* Gërshetimi i parimeve shkencore të letërsisë së krahasuar me ato të studimeve kulturore.

*Rezultati:* Gjetja e pikave të përbashkëta, por edhe të vijave dalluese mes ninullave malazeze dhe atyre shqiptare të veriut.

# **STATUSI I SHQIPES NË MAL TË ZI DHE ROLI I SAJ NË EDUKIM**

**Mimoza PRIKU**

Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

## **Abstrakti**

Pozita gjeografike e shqipes dhe pikëtakimet e saj me gjuhë të ndryshme ballkanike kanë ngjallur interes për ta njohur më nga afër këtë gjuhë e për ta studiuar atë. Falë kësaj vëmendjeje, por edhe domosdoshmërie nga ana tjetër, për të mos shkëputur hallkat e zinxhirit ballkanik, shqipja edhe sot është një gjuhë që lektorohet në disa katedra të shpërndara në Europë, Amerikë e gjetkë.

Fokusi ynë do të lidhet me disa diskutime që prekin statusin e shqipes në Mal të Zi, si gjuhë e cila është pjesë e edukimit të një pjese të popullsisë së këtij shteti fqinj. Më konkretisht trajtimet do të prekin themelimin, rritjen e përparimit të degës së Mësuesisë që përgatitë mësues të arsimit fillor në gjuhën shqipe. Me ndryshimet e rekomanduara kryesisht nga Këshilli European, si dhe me arritjen e miratimit të ligjeve ndërkombëtare mbi gjuhët

e pakicave, u bë e mundur edhe hapja e një fakulteti që do të përgatiste mësues për shkollat fillore në gjuhën shqipe. Si pikë strategjike u përzgjedh Podgorica, jo vetëm për rolin si kryeqytet, por edhe si një mundësi e integritit gjuhësor, kulturor e ndëretnik të studentëve shqiptarë.

*Fjalë kyçe:* gjuhë shqipe, integritit gjuhësor, dygjuhësi.

# **GJAMA DHE VAJTIMET SI SIMBOLE UNIVERSALE DHE PJESË E ANTROPOLOGJISË KULTURORE**

**Rrezarta DRAÇINI<sup>1</sup>, Merita HYSA<sup>2</sup>**

<sup>1</sup> Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

<sup>2</sup> Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

## **Abstrakti**

Dhimbja për vdekjen e një personi të dashur e ka shoqëruar njerëzimin që në ekzistencën e tij dhe ashtu si çdo ndjenjë tjetër është universale.

Edhe gjuha - mjete me të cilin qeniet njerëzore bëjnë konkrete dhimbjen e tyre - është universale. Dy universale që kanë bashkëjetuar duke “ushqyer” njëra tjetrën.

Forca e dhimbjes në mendjen dhe shpirtin e njeriut ka bërë të mundur që gjuha të prodhojë mjete të jashtëzakonshme për ta konkretizuar atë dhe anasjelltas. Për mijëra vjet, përmes gjuhës (vajtimeve dhe gjamave) është shprehur dhimbja, trishtimi dhe hidhërimi, ndaj këngët e vajit apo vajtimet janë pjesë shumë e rëndësishme e etnokulturës dhe trashëgimisë së popujve.

Në këtë punim do të ndalemi tek vajet dhe gjamat për të analizuar konkretisht të përbashkëtat dhe të veçantat e tyre në arealin ballkanik. Mes këndvështrimeve antropologjike, simbolike dhe gjuhësore do të shohim si kanë evoluar ato. Duke studiuar vajtimet, gjamat dhe namat vihen re ngjashmëri të mëdha mes tyre në zonën e Ballkanit dhe jo vetëm, pavarësisht vendit se ku bëhet vajtimi apo nama. Simboli dhe metafora janë në qendër të tyre. Përtej këtyre të përbashkëtave secila zonë ka individualitetin e vet, nisur nga veçoritë e tyre kulturore, fetare apo gjuhësore.

*Fjalët kyçe:* gjama, vajet, etnokulturë, Ballkan, Shqipëri, antropologji.

# KONTAKTET GJUHËSORE SHQIPTARO – MALAZEZE

(Një vështrim historik e gjuhësor mbi disa glosa)

**Erzen KOPERAJ<sup>1</sup>, Orjeta BAJA<sup>2</sup>**

<sup>1</sup> Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

<sup>2</sup> Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

## **Abstrakti**

Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze kanë një kohështrirje relativisht të gjatë. Ato paraqiten mjaft komplekse në rrafshin historiko shoqëror, por edhe atë gjuhësor. Ato duhet të fillojnë që me ardhjen e popujve sllavë në Ballkan, në periudhën e Mesjetës së Hershme, për të ardhur në periudhat e vona me marrëdhënie kontakti (adstrati), por edhe simbioze midis dy popujve. Në Ballkan, te popujt sllavë të jugut, identitetet gjuhësore kanë përjetuar luhata të shumta, kryesisht nën ndikimin e faktorëve fetarë, politikë e kulturorë. Deri në dekadat e fundit, të folmet në territorin e Serbisë, Kroacisë, Bosnjes dhe Malit të Zi, zakonisht janë etiketuar si serbisht (zyrtarisht gjuha serbo-kroate deri më 1995),



duke anashkaluar dallimet që më pas i dhanë jetë gjuhëve të reja zyrtare që u krijuan pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Ne jemi ndalur te kontaktet gjuhësore të shqipes dhe të folmeve sllave malazeze (sot zyrtarisht gjuha malazeze) pasi paraqesin një rast të veçantë në lidhjet komplekse që ato paraqesin, qoftë në historinë e tyre, po ashtu dhe në përhapjen gjeografike të tyre. Këto kontakte janë shtrirë në kufijtë veriperëndimorë të shqipes, pikërisht në arealin gjuhësor që përfshin Shkodrën dhe zonat përreth saj. Autorët duke u mbështetur në kriteret e gjeografisë gjuhësore synojnë të paraqesin në vija të përgjithshme elemente e dukuri që në shqipe e në të folmet malazeze kanë hyrë vetëm përmes kontakteve të tyre në këtë hapësirë, ku jo vetëm janë krijuar, por edhe kanë mbetur të kufizuara vetëm brenda saj.

*Fjalët kyçe:* gjuhët sllave, të folmet malazeze, gjuha shqipe, marrëdhëniet gjuhësore, gjuhësi ballkanike.

# **MBËSHTETJA AKADEMIKE PËR LETËRSINË NË DY GJUHË FQINJE**

**Gëzim PUKA**

Departamenti i Letërsisë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

## **Abstrakti**

Ky shkrim synon të paraqesë disa nga momentet e rëndësishme të bashkëpunimit mes dy letërsive: shqipe dhe malazeze. Në të do të shtjellohet roli domethënës i ndërmejtësisimit akademik në këto raste. Do të trajtohet vlera që kanë institucionet akademike dhe kulturore në prodhimin e promovimin e përmbledhjeve serioze të teksteve letrare, siç është rasti i antologjive dygjuhëshe.

Do të përkujtohet një ngjarje letrare e ndodhur disa vjet më parë me antologjinë “Dy gjuhë – një libër”, që u mbështet dhe u promovua edhe nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, duke përcjellë respektivisht në dy gjuhë autorë të spikatur shqiptarë të Veriut dhe autorë malazezë.

E ngjashme është edhe antologjia “Të gjithë tanët” (Svi naši) – Antologji e prozës së shkurtër e shkrimtarëve shqiptarë në Mal të Zi, botuar nga Qendra për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Kulturës së Pakicave të Malit të Zi në vitin 2022 në Podgoricë.

Përmes kësaj kumtese do të rifreskohet dhe do të rivlerësohen këto raste konkrete të kontributit të pedagogëve të Universitetit të Shkodrës për të nxitur dhe rigjallëruar nisma të tilla. Prurjet letrare në formën e antologjive të teksteve më të spikatura të shkrimtarëve shqiptarë dhe malazezë në të dyja anët e kufirit, i shërbejnë ruajtjes së ngjyrave dhe profilit origjinal të krijuar nga kjo letërsi. Qëllimi i këtij shkrimi është të tregojë se arti i fjalës, para së gjithash, ka epërsinë të shembë barrierat ideologjike dhe politike, si dhe është mjete estetiko-etik më qytetërues.

*Fjalë kyçe:* antologji, letërsi, dygjuhësh, përmbledhje, promovim.

# **BOHEMIAN QUARTER SKADARLIJA IN THE CITY OF BELGRADE. REPRESENTATIONS OF CONSTRUCTED SPIRIT OF THE CITY**

**Maša VUKANOVIĆ (Masha Vukanovic)**

Institute for Cultural Development Studies, Belgrade, Serbia

## **Abstract**

Present day Bohemian quarter Skadarlija is a must-see attraction situated in the very center of the Serbian capital, the City of Belgrade.

Formed at the turn of the 19<sup>th</sup> and 20<sup>th</sup> centuries, quarter consists of Skadarska street (named after the City of Skadar) and surrounding George Washington, Gospodar Jovanova, Gospodar Jevremova, Cetinjska and Zetska streets.

Core of the paper is a presentation of Skadarlija - from the muddy cobble-stoned streets where artists, intellectuals, and other bohemians spent days and nights in taverns (kafana), discussing and creating arts, as well as discussing various socio-economic and political

issues, to polished representation of old urban culture for the tourists.

Such evolution speaks about politics of city's representation, and about the development of cultural tourism, leading branch of contemporary tourism industry.

*Keywords:* Skadarlija, arts, taverns, spirit of the city, urban development, cultural tourism

# **INCLUSIVE INTANGIBLE CULTURAL HERITAGE RESEARCH AND SAFEGUARDING IN THE WESTERN BALKANS: ISSUES, PERILS, OPPORTUNITIES**

**Miloš MILENKOVIĆ**  
University of Belgrade

## **Abstract**

In this presentation, special attention will be dedicated to the potential of intangible cultural heritage (ICH) as the "core" of cultural identity, composed of customs, beliefs, language, and self-representations. It not only has the potential to provoke conflicts on ethnic and confessional grounds but also contributes to reconciliation and development in the Western Balkans region. While the majority of the academic community opposes essentialization, commodification, touristification, and trivialization of culture, tradition, and identity through the heritage paradigm, my previous research indicates the opposite. This is particularly interesting considering the fact that Croats, Serbs, Montenegrins, Bosniaks, Macedonians, and Albanians share certain elements of ICH throughout the Western Balkans region, even though these elements are safeguarded separately and

sometimes competitively. Instead of emphasizing their historical origins contributing to the disputes over identity appropriation, the heritage paradigm directed by UNESCO towards reconciliation and development can function if these elements are studied and protected collectively and inclusively. This requires the establishment of new and improvement of existing forms of collaboration among our institutions of science, higher education, and culture. I hope that the Cultural Meeting Points in the Balkan Area conference will be an opportunity to collectively reconsider ICH as such a cultural meeting point, in terms of academic and cultural collaboration, as well as cultural diplomacy.

*Keywords:* anthropology, intangible cultural heritage, intercultural relations, heritage diplomacy, Western Balkans

# KULTURAT E RREZIKUARA NË NOVELAT E MARTIN CAMAJT

**Arben PRENDI**

Departamenti i Letërsisë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

## **Abstrakti**

Në të gjithë veprën letrare të Martin Camajt, në poezi dhe në prozë, gjejmë shqetësimin për kulturat e rrezikuara nga asimilimi prej kulturave të mëdha:

prej rrjedhave të kohës dhe qytetërimeve;

prej izolimit gjeografik, politik, ekonomik apo kulturor;

prej vetëshmangies apo vetëmbylljes në guackën e vetmisë dhe refuzimit;

prej dukurisë së shpopullimit dhe emigrimit etj.

Në këtë kumtesë, janë analizuar këto tema vetëm në prozat novelistike: “Katundi me gjuhë të fshehtë”, “Rungaja në mars”, “Shkundullima”, “Gjon Gazulli”, “Pishtarët e natës” etj., ku kryesisht rrëfëhet për mbijetesën dhe tjetërsimin e kulturave të vogla, në malësitë e Veriut të Shqipërisë apo në katundet arbëreshe të Italisë.



Në këto mjedise, për Camajn, gjenden mbijetojat e një kulture dhe identiteti në zhdukje, mbijetojat e kulturës dhe qytetërimit të lashtë shqiptar, rrezikimi i të cilave, i brengos fort personazhet letrare por edhe vetë autorin.

*Fjalë kyçe:* kulturat e rrezikuara, identitetet dhe qytetërim shqiptar, tjetërsim kulturor, kultura të vogla.

# TAKIMI ME TJETRIN SI SFIDË APO MUNDËSI?

**Valbona KARAKAÇI**

Departamenti i Letërsisë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

## **Abstrakti**

Ky punim synon të hulumtojë në mënyrë jo shteruese takimin e tensionuar me Tjetrin në Ballkanin e Jugut. Frymëzuar nga historia e letërsisë dhe civilizimit, ai tenton të vendosë në ekuilibër e të përkufizojë marrëdhënien me Tjetrin në Ballkanin e Jugut (Shqipëri, Serbi, Maqedoni e Veriut, Kosovë) si reflektim i një perceptimi më të gjerë mbi Tjetrin në Ballkan e Europë. Duke përdorur metoda diakronike e sinkronike punimi eksploron Takimin me Tjetrin si një rrethanë autentike jo e thjeshtë, nga ku ngjizet një marrëdhënie që shenjon sa historinë personale, aq dhe atë kombëtare e rajonale. Tjetri si problem etik i kulturës europiane e ballkanase mundet me qenë edhe “thembra e Akilit” për një shoqëri multikulturore në paqe e siguri harmonike, nëse pranohet e kultivohet si liri zgjedhjeje në diversitet. Duke theksuar nevojën për Tjetrin, punimi që ka natyrë publicistike dhe shkencore, vë theksi tek plotësia që sjell Tjetri në jetën e shoqërive tona, që janë “të detyruara” të

zhvillojnë identitetin e ri global pa rënë në “kurthet historike” të armiqësisë me tjetrin. Punimi ndërton mbi analizën e katër eseve mbi Prespektivën e Ballkanit të Jugut (Dimitrios Triantaphyllou, 2001) e specifikisht Shqipërisë, Maqedonisë (në atë kohë jo të Veriut), Serbisë dhe Kosovës: si i tillë ai sjell një perceptim të fiksuar në kohë, por tenton edhe të arrijë në përfundime me natyrë përgjithësuese mbi *Ballkanasit dhe Të tjerët* dhe *Tjetrin në Ballkanin e Jugut* gjatë periudhës së tranzicionit postkomunist dhe shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.

*Fjalë kyçe:* Tjetri si Armik, Tjetri dhe Uni, Tjetri Homogjen, Tjetri i Pakuptuar, Tjetri etnik-kulturor-fetar, Tjetri periferik, Tjetri iIntegruar, Tjetri Historik etj.

# **KULTURA DHE INTEGRIMI NË EDUKIMIN BASHKËKOHOR, NJË TIPAR DALLUES NË SHKRIMET PUBLICISTIKE TË GJERGJ FISHTËS**

**Rovena VATA MIKELI**

Departamenti i Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe  
Letërsisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë

## **Abstrakti**

Në këtë trajtesë objekt studimi do jetë kultura dhe integrimi në edukimin bashkëkohor që kishte Gjergj Fishta në vizionin e tij si publicist. Qëllimi i këtij punimi do kenë në fokus krijimtarinë publicistikë të Gjergj Fishtës, koncepti i tij për kulturën dhe integrimin në edukimin perëndimor, evropian dhe bashkëkohor. Metodologjia e këtij punimi do jetë një kombinim i metodave krahasuese, semiotike, antropologjike, biologjike dhe sociale.

Rezultatet e pritshme të këtij studimi lidhen me kuptimin bashkëkohor të konceptit culture, sipas Fishtës, të cilën e lidhte pandashmërisht me shkollën, dijen dhe njeriun. Shkolla që Fishta sugjeronte për shqiptarët sipas modelit evropian, duhet të ishte e përbërë prej: frymës besimtare, elementit atdhetar dhe punës sistematike, vetëm kështu

mendonte ai mund të shkojë Shqipëria, drejt një rrugë të re të zhvillimit dhe të emancipimit, në përshtatje me kulturën, integrimin dhe edukimin bashkëkohor.

Rekomandime: Gjergj Fishta rekomandonte referimin ndaj kulturës perëndimore evropiane, duke u mbështetur në modelet e saj më të mira për shqiptarët, teksa vlerësonte se këto modele ishin ngritur mbi bazën e punës dhe të një sistemi të mirëorganizuar, i cili përbën bazën e themelit të shoqërisë njerëzore me frymë perëndimore evropiane.

*Fjalë kyçe:* Shkolla, dija, organizimi shoqëror, kultura perëndimore e Evropës, kultura evropiane, populli shqiptar.

# MISIONI NDËRKULTUROR I SHTËPISË BOTUESE “DIELLI” (BEOGRAD-PRISHTINË)

**Rezearta MURATI**

Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

## **Abstrakti**

Prej vitesh në Beograd po jep një kontribut me vlera të shumëanshme një shtëpi botuese që mision të sajën ka njohjen e “Vetes” dhe “Tjetrit” përmes Librit. Që në përzgjedhje të emërtesës “Dielli”, qëllimi i themeluesve bëhet i qartë dhe motivon përzgjedhjen nga autorët dhe lexuesit. Shtëpia botuese “Dielli”, me seli në Beograd e Prishtinë, e themeluar nga Petrit Imami dhe Naile Mala Imami mundëson botimin e veprave pak ose aspak të njohura, që lidhen me perceptimin e dy popujve, atij shqiptar dhe serb. Synon të informojë për libra të shkruar për njëri-tjetrin në dy shekujt e fundit, pavarësisht vizionit për mirë ose për keq, sepse vetëm njohja e plotë jep një mundësi më të mirë për të gjykuar. Aty punohet paralelisht për botimin e të gjithë librave në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe. Punimi ynë ka për qëllim të

paraqesë një panoramë të botimeve të realizuara, duke u ndalur në arsyet përzgjedhjes, mesazhet që përçohen dhe vlerat ndërkulturore të këtyre librave. Gjurmimi i pikave të përbashkëta për kulturat shqiptare dhe serbe nuk mund të perceptohet si një mision i pamundur, sepse kultura më shumë se çdo aspekt tjetër i jetës shoqërore mund të jetë ndërmjetësuese për ndërtimin e urave të dialogut, bashkëpunimit dhe zhvillimit. Multikulturalizmi ballkanik është një realitet ku ngërthehen rrafshe multidimensionale që kërkojnë interpretim, por dhe mbështetje me nisma konkrete, siç është kjo e Shtëpisë Botuese “Dielli”.

*Fjalët kyçe:* Shtëpia Botuese “Dielli”, libra, shqip, serbisht, kulturë, njohje, mesazh, dialog, multikulturalizëm ballkanik.

# **TË VAJTOSH NË BALLKAN –ELEMENTE TË PËRBASHKËTA TË RITUALIT MORTOR NË BALLKAN**

**Ledia DUSHI**

## **Abstrakti**

Popujt ballkanikë, sado të ndryshëm të jenë, kanë kaluar nëpër të njëjtin kohezion historik dhe kulturor, i cili reflektohet më së shumti në identitetet e tyre kulturore, të njohura dhe të përcaktuara brenda hapësirës së tyre gjeografike. Premisa e kësaj qasje është se zakoni bart kuptimin e të jetuarit, brenda kontekstit të saj historik, gjë që pasurohet edhe nga të dhëna të tjera që plotësojnë informacionin, si gjuha dhe përcaktimet gjuhësore.

E gjithë kjo shërben si bazë e vrojtimit etnokulturor të cikleve të jetës, veçanërisht të vdekjes. Çabej konsideron se çështje të tilla etnologjike janë “mbetje të kohëve të vjetra pagane, të cilët kanë veshur gjatë kohës rrobat e krishtera dhe më vonë ato islame, duke ruajtur këtë metamorfozë”.

Studime të ndryshme ballkanike bazohen në veçori të përbashkëta, që trajtojnë këtë zonë të njohur, e cila po



afrohet jo vetëm gjeografikisht, por edhe në fushën e marrëdhënieve kulturore. Ndërveprimi kulturor është reflektuar fuqishëm në zakonet e popujve, të cilët janë edhe mbrojtësit më të fortë të prezencës kulturore dhe historike, e cila shpesh trajtohet si një çështje problematike dhe konfliktuale, si për shembull: cila është kënga, cila është historia, cila është festa etj. Por vështrimi im nuk propozon konfliktin apo garën, krejt e kundërta, propozon parashtrimin e të dhënave që janë thurur prej një avlëmendit të përbashkët historik.

Ky zhvillim nuk i përket vetëm së kaluarës, por është i rëndësishëm edhe për të ardhmen, duke kapërcyer përkufizimin gjeografik dhe rajonal, duke kapërcyer opinionet egocentrike të rretheve të shkencëtarëve, për të bërë një bazë më të fortë të respektimit më të gjerë në identifikimin e problemeve, pavarësisht nëse janë kulturore, por që do mund të ndihmojnë jo vetëm çështje etnokulturore në përgjithësi, por edhe disiplina të tjera shkencore.

# **PASQYRIMI I KONFLIKTIT NDËRETNIK NË MEDIAT SHQIPTARE DHE SERBE**

**(Rast studimor: Banjaska)**

**Isida HOXHA<sup>1</sup>, Ismet KALLABA<sup>2</sup>**

<sup>1</sup>Departamenti i Letërsisë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

<sup>2</sup>Departamenti i Letërsisë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

## **Abstrakti**

Roli i medias në pasqyrimin e konflikteve ndëretnike ka ndikim të madh në formësimin e opinionit publik, sepse mënyra sesi media na e ka prezantuar atë ndikon në perceptimet tona për të tjerët. Mediat kanë fuqinë të krijojnë dhe të përforcojnë ligjërimin ekzistues mbi tjetrin. Mediat në vendet e Ballkanit kritikohen shpeshherë për rolin e tyre luftënxitës në konfliktet ndëretnike në ish-Jugosllavi. Ky artikull ka për qëllim të hulumtojë mënyrën e raportimit të mediave në Shqipëri dhe Serbi në rastet e konflikteve ndëretnike. Si rast studimor është marrë konflikti i armatosur ndërmjet pjesëtarëve të Policisë së Kosovës dhe një grupi të serbëve të armatosur, në fshatin Banjaska, në veri të Kosovës, më 24 shtator të këtij viti. Kemi përzgjedhur

disa nga mediat kryesore në Shqipëri dhe Serbi për analizën krahasuese sesi e kanë mbuluar ato këtë ngjarje. Një ndër përfundimet e artikullit është se raportimi mbi baza nacionale jo vetëm që nuk i shërben së vërtetës, por kontribuon në thellimin e ndarjeve dhe paragjytimeve ndërmjet popujve.

*Fjalë kyçe:* media shqiptare/serbe, raportim i medias, ligjërimit, etikë e medias.